



Komuna e Klinës
Kryetari i Komunës
01/2020
Klinë, dt.03.04.2020

Duke u bazuar në nenin 13, 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në gazetën zyrtare nr. 28/2008 të publikuar me dt.04.06.2008, nenin 91 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Klinës të dt. 07.04.2010, vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/07 të datës 11.03.2020 dhe plotësim ndryshimit të tij, lidhur me gjendjen e krijuar me qëllim të parandalimit nga infeksioni i Corona Virus COVID-19, si dhe vendimin nr.01/11 të datës 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, me akordimin edhe të grupit për gatishmëri emergjente të datës 03.04.2020, Kryetari i Komunës së Klinës, më dt. 03.04.2020, **merr;**

V E N D I M

1. **MIRATOHET**, Propozim Projekti i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, **Shërbimi Specifik në Shtëpi**, i datës 31.03.2020. Ky projekt ka për qëllim ofrimin e shërbimeve mjekësore në shtëpi për pacientet me sëmundje kronike, të moshuarit, shtatzënat dhe të sapolindurit, gjatë fazës emergjente të krijuar si pasojë e virusit COVID-19.
2. Zbatimi i këtij vendimi dhe projektit të miratuar behet nga ana e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me QKMF "Nënë Tereza" në Klinë.
3. Vendimi i është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohet:

- DSHMS;
- QKMF "Nënë Tereza" Klinë
- Shtabi emergjent;
- Tabelën e shpalljeve;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Elezaj